

Politika për privatësinë për regjistrimet video në kuadër të xhirove të testimit

A. Kontrolluesi

Me këtë politikë për privatësinë ne ju informojmë në lidhje me mbledhjen, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave tuaja personale nga ana e Volkswagen AG, Berliner Ring 2, 38440 Wolfsburg, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Braunschweig me HRB 100484 ("Volkswagen AG").

B. Mbledhja, përpunimi dhe përdorimi i të dhënave tuaja personale

1. Parimet themelore

Për zhvillimin (e mëtejshëm), testimin dhe sigurimin në fushën e sistemeve të asistencës për shoferin dhe të informacionit për shoferin, të funksioneve të automatizuara të drejimit dhe të komoditetit, si dhe të shërbimeve të tjera, Volkswagen AG përdor të ashtuquajturat automjetet e testimit. Në automjetet e testimit të identikuara në mënyrë të posaçme ndodh regjistrimi i të dhënave si rezultat i përdorimit të sensorëve, të pajisjeve matëse dhe i teknologjisë matëse me video.

Si rezultat, përpunimi i të dhënave tuaja personale bëhet në lidhje me krijimin dhe vlerësimin e regjistrimeve video nga kompania e transportit publik, gjatë realizimit dhe analizës së udhëtimeve provë të zhvillimit dhe sigurimit nga Volkswagen AG. Nga ky përpunim i të dhënave ka të ngjarë të preken ata persona që gjatë operacioneve të testimit dhe të sigurimit qëndrojnë në afërsi të një prej automjeteve të identikuara si automjete testimi.

Regjistrimet e të dhënave nevojiten për qëllimet e zhvillimit dhe qëllimi i tyre është përmirësimi i sigurisë së produktit, automjetit dhe i sigurisë në qarkullim, si dhe shmangia e aksidenteve rrugore.

Të dhënrat e regjistruarat të mjedisit përreth ruhen më pas në një bazë të sigurt të dhënash dhe përdoren për zhvillimin (e mëtejshëm) dhe sigurimin e sistemeve të asistencës për shoferin dhe të informacionit për shoferin, të funksioneve të automatizuara të drejtimit dhe të komoditetit.

Mbi bazën e këtyre të dhënave, në kontekstin e rrethanave reale të qarkullimit dhe të ambientit zhvillohet në veçanti përmirësimi i komoditetit dhe i sigurisë së automjetit, si dhe kryhet zhvillimi, testimi dhe sigurimi i automjeteve të pavarura dhe i sistemeve të lidhura me to, për qarkullimin e sigurt dhe në përputhje me rregullat në rrugë.

Përveç kësaj, të dhënrat video të regjistruarat shërbejnë për të siguruar funksionet e automjetit. Përpunimi i infrastrukturës rrugore ekzistuese dhe identifikimi i mjedisit përreth automjetit, i pengesave dhe i kushteve mjedisore (p.sh. aftësia kundër rrëshqitjes ose kufizimi i shikueshmërisë për shkak të ajrit të ndotur), si dhe i përdoruesve të tjerë të rruget, duke përfshirë edhe drejtimin e tyre të lëvizjes, nevojitet për të nxjerrë reagimin e duhur të automjetit.

Në asnjë moment Volkswagen AG nuk identifikon asnjë person të veçantë në grupet e të dhënave.

2. Kategoritë e të dhënave që preken dhe qëllimet e përpunimit

Për qëllimet e zhvillimit (të mëtejshëm), të testimit dhe të sigurimit, si dhe për marrjen e masave të duhura për garantimin e cilësisë së sistemeve të asistencës për shoferin dhe të informacionit për shoferin, si dhe të funksioneve të automatizuara të drejtimit dhe të komoditetit dhe të shërbimeve të tjera, mblidhen dhe përpunohen të dhënrat e mëposhtme:

- Regjistrime video të përdoruesve të tjerë të rruget (automjete dhe persona)
- Targat dhe shkrimet mbi automjete;
- Shkrimet në tabelat e dyqaneve dhe në tabelat e qarkullimit rrugor, dhe
- Informacione të tjera në ambientin shumë afér automjeteve të testimit, të cilat registrohen nga kamerat.

Shënim: Përkthimi në shqip është përgatitur sipas njohurive tona më të mira. Në rast të devijimeve në përbajtje, do të vlefjë origjinali në gjermanisht.

Shënim: Përkthimi në shqip është përgatitur sipas njohurive tona më të mira. Në rast të devijimeve në përmbajtje, do të vlejë origjinali në gjermanisht.

3. Marrësit

Brenda Volkswagen AG, akses në të dhënat tuaja kanë vetëm ata persona, të cilët i kanë të nevojshme këto të dhëna për qëllimet e përmendura në pikën II.

Nëse Volkswagen AG i ndan të dhënat e sipërpermendura me ofruesit e shërbimeve dhe/ose me partnerët e bashkëpunimit, kjo bëhet vetëm duke respektuar të drejtat e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënavëve. Ofruesit e shërbimit që përdoren nga Volkswagen AG (të ashtuquajturit "përpunuesit e të dhënavëve"), që marrin të dhëna janë, ndër të tjera:

- Kompanitë e grupit VW që ofrojnë shërbime (p.sh. shërbimet e zhvillimit) për VW AG,
- Ofruesit e shërbimeve të zhvillimit jashtë grupit VW,
- Furnizuesit e komponentëve të sistemeve të asistencës për shoferin të lidhura me sigurinë
- Ofruesit e shërbimeve të hostimit,
- Ofruesit e shërbimeve IT.

Secila prej këtyre sipërmarjeve është e lidhur në fazën e zhvillimit të produktit dhe të vlerësimit të testeve. Volkswagen AG është e gatshme që t'ju vendosë në dispozicion, me kërkesë, informacionet e tjera për marrësit e të dhënavëve në rastin e xhirove konkrete të testimit. Jeni të lutur që për këtë qëllim të përdorni të dhënat e kontaktit më poshtë.

Nëse marrësit e të dhënavëve ndodhen në një shtet jashtë Bashkimit Evropian ose jashtë Zonës Ekonomike Evropiane (të ashtuquajtura "shtete të treta"), të dhënat mund të transferohen në një shtet ku ndoshta nuk ekziston një nivel i përshtatshëm ose ku nuk ekziston fare një nivel i mbrojtjes së të dhënavëve i krahasueshëm me Bashkimin Evropian. Për transferimet e të dhënavëve në këto shtete të tretë ku nuk ekziston asnjë nivel i përshtatshëm për mbrojtjen e të dhënavëve, Volkswagen AG ka marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mbrojtur të dhënat tuaja personale.

4. Baza ligjore përpunimin e të dhënave

Të dhënat tuaja personale mblidhen, përpunohen dhe transferohen vetëm për qëllime të caktuara dhe vetëm kur për këtë qëllim ekziston baza ligjore përkatëse.

Volkswagen AG i përpunon të dhënat tuaja në bazë të interesave të saj legjitime për qëllimet e zhvillimit, testimit dhe sigurimit, si dhe për marrjen e masave të duhura të garantimit të cilësisë. Kjo prek në mënyrë të veçantë zhvillimin dhe sigurimin e sistemeve të asistencës për shoferin dhe të funksioneve të drejtimit plotësisht ose pjesërisht të automatizuara, në mënyrë që të rritet siguria e qarkullimit në trafikun rrugor publik.

Informacione për të drejtat tuaja, duke përfshirë edhe të drejtën tuaj për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave personale gjeni në seksionin C të kësaj deklarate.

5. Kohëzgjatja e përpunimit dhe fshirja e të dhënave

Nëse nuk ka asnjë bazë ligjore të veçantë, me të cilën bie në kundërshtim, ruajtja e të dhënave bëhet për aq kohë sa është e nevojshme për qëllimet e përpunimit.

Ruajtja e mëtejshme e të dhënave tuaja mund të jetë e nevojshme për qëllimet e sigurimit të cilësisë dhe të eliminimit të defekteve të sistemeve të sipërpërmendura, pas vendosjes së tyre në treg. Përveç kësaj, në rrethana të caktuara ne i ruajmë të dhënat tuaja për qëllimet e ruajtjes së dëshmive për ekzekutimin e pretendimeve ligjore ose për t'u mbrojtur ndaj tyre. Të dhënat tuaja fshihen maksimumi pas përfundimit të afateve të zbatueshme për periudhën e ruajtjes.

C. Të drejtat tuaja

Të drejtat tuaja të mëposhtme ju mund t'i kërkonit në çdo kohë kundër Volkswagen AG pa asnjë detyrim financiar. Të dhënat përkatëse të kontaktit, për respektimin e të drejtave tuaja i gjeni në seksionin D.

Shënim: Përkhimi në shqip është përgatitur sipas njohurive tona më të mira. Në rast të devijimeve në përbajtje, do të vlefjë origjinali në gjermanisht.

E drejta për informim: Ju keni të drejtën të merrni informacion përpunimin e të dhënavë tuaja nga ana jonë.

E drejta për korrigjim: Ju keni të drejtën të kërkonit korrigjimin e menjëherëshëm të të dhënavë tuaja personale që ne kemi ruajtur, të cilat janë të pasakta ose të paplota.

E drejta për fshirje: Ju keni të drejtën të kërkonit fshirjen e të dhënavë tuaja. Më pas, për shembull, ju mund të kërkonit fshirjen e të dhënavë tuaja, nëse arsyet për të cilat ato janë mbledhur nuk janë më të nevojshme. Përveç kësaj, ju mund të kërkonit fshirjen edhe nëse ne përpunojmë të dhënat tuaja në bazë të pëlqimit tuaj dhe më pas ju e tërhoiqni këtë pëlqim.

E drejta për kufizimin e përpunimit: Ju keni të drejtën të kërkonit kufizimin e përpunimit të të dhënavë tuaja. Ky për shembull është rasti, nëse ju keni kundërshtime për saktësinë e të dhënavë tuaja. Ju mund të kërkonit kufizimin e përpunimit deri në momentin e verifikimit të saktësisë së të dhënavë tuaja.

E drejta e kundërshtimit: Nëse përpunimi i të dhënavë bazohet në një interes legjitim mbizotëruesh, ju keni të drejtën të kundërshtonit përpunimin e të dhënavë tuaja. Kundërshtimi është i pranueshëm nëse përpunimi është në interesin publik apo për ushtrim të autoritetit zyrtar, apo kur ai kryhet për interesat legjitime të Volkswagen AG apo të një pale të tretë. Në rastin e kundërshtimit, ju lutemi të ndani me ne arsyet tuaja, për të cilat kundërshtoni përpunimin e të dhënavë.

E drejta e ankimit: Ju keni të drejtën të ankoheni pranë një autoriteti mbikëqyrës përpunimin e të dhënavë tuaja nga ana jonë.

D. Personi i kontaktit

Personi i kontaktit për ushtrimin e të drejtave tuaja

Personat e kontaktit për ushtrimin e të drejtave tuaja dhe për informacione të mëtejshme i gjeni në faqen e mëposhtme të internetit
<https://datenschutz.volkswagen.de>.

Autoriteti përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave

Autoriteti ynë përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave shërben si person kontakti për çështje lidhur me mbrojtjen e të dhënave:

Datenschutzbeauftragter der Volkswagen AG
Berliner Ring 2, 38440 Wolfsburg, Deutschland
datenschutz@volkswagen.de

Versioni: Prill 2021